

ARTIKULLI #6

AKTIVITETI I USAID OFRON KURSE ONLINE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË PËRSHTATUR SIPAS KËSHILLAVE DHE NEVOJAVE TË STUDENTËVE.

Kurset ndihmojnë në menaxhimin e mësimnxënies me përvojë për studentë të bujqësisë dhe TIK në Kosovë

JULY 3, 2023

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në link:

<https://drive.google.com/drive/folders/13HjHKwjvhJnU35vqEyFpW5hfaS25qlf1>

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe bizneset bujqësore në Kosovë po punojnë së bashku për të krijuar kanale për studentë të talentuar universitar, që të përfitojnë përvoja të zhvillimit profesional, të mësojnë rreth trendeve aktuale në fushat e studimit, dhe të krijojnë lidhje me kompani lidere të industrisë – e gjithë kjo gjatë kohës sa janë në studime.

Aktiviteti i USAID Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë, i implementuar nga Universiteti i Iowa (UI) në partneritet me Universitetin Shtetëror të Iowa (USI) dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), mbështet bashkëpunimin e suksesshëm mes studentëve të TIK dhe Bujqësisë dhe bizneseve në Kosovë. Për të harmonizuar përpjekjet me nevojat e industrisë, pjesëmarrësit po takohen me biznese lidere të TIK dhe Bujqësisë, duke eksploruar programet e tyre ekzistuese të praktikës së punës, trajnimeve, dhe praktikave.

Ekspertët nga Iowa po bashkëpunojnë me kolegë dhe staf universitar nga Kosova, studentë, dhe kompani për të mësuar se cilat janë nevojat për të nxjerrë më të mirën nga praktika e punës. Burimet e dizajnuara posaqërisht të praktikës së punës, të cilat janë duke u zhvilluar, do t'u ndihmojnë studentëve të mësojnë së çfarë nevojitet për të pasur sukses në një ambient pune, për të harmonizuar pritshmëritë e studentëve dhe industrisë, dhe për të lehtësuar sfidat administrative me të cilat përballen bizneset gjatë implementimit të një programi të praktikës së punës.

Chris Kromphardt, koordinator për përgatitje të karrierës dhe sukses, dhe instruktor në Kolegjin e Edukimit të UI, u takua me akterë për të mbledhur informata rreth pritshmërive dhe objektivave. Së bashku me kolegë nga Kosova, ai mbajti fokus grupe me studentë në të tri universitetet publike partnere, udhëhoqi punëtorë me stafin e qendrave të karrierës, dhe u takua me përfaqësues nga biznese të ndryshme të TIK dhe bujqësisë.

“Takimet ishin shumë të vlefshme për të mësuar se si të ndihmojmë në mbështetjen e objektivit tonë në avansimin e rritjes ekonomike të Kosovës dhe konkurrueshmërisë në rajon. Në vend se të provojmë të krijojmë një model të vetëm për punë praktike dhe mësimnxënie me përvojë, ne dëshiroam të degjojmë vetë se si janë punët praktike në Kosovë dhe si mund të zhvillohen ato”, thotë Kromphardt. “Gjithashtu, për shkak që ne folëm me shumë nga njerëzit që ofrojnë dhe marrin pjesë në punë praktike, ne ishim në gjendje të transmetonim informacionin që kishim mësuar, në mënyrë që të gjithë të jenë në të njëjtën faqe.”

Takimet zbuluan që si studentët, ashtu edhe bizneset ishin në gjendje të shihnin përfitimet e punës praktike të ekzekutuar mirë. Për të krijuar një proces të strukturuar, Kromphardt është duke udhëhequr zhvillimin e kurseve online, të cilat do të ndihmojnë si studentët ashtu edhe bizneset. Kurset do të kombinojnë njohuritë mbi praktikën më të mira aktuale për punë praktike nga bizneset në Kosovë, me parime të dizajnit udhëzues për mësimnxënie online.

“Mësuam shumë se si të dizajnojmë kurset për kontekstin unik të Kosovës. Ne dëshirojmë t'i bëjmë kurset informative dhe lehtësisht të përdorshme, dhe e ndjej që të gjithë jemi mirë të përgatitur për të përmbushur këto objektiva”, thotë Kromphardt. *“Këto kurse do të jenë të qasshme për të tre akterët, duke i pajisur ata me aftësitë e nevojshme për bashkëpunim efikas. Objektivi ynë është të sigurojmë mbarëvajtje të qetë për secilën fazë të procesit të praktikës së punës, përfshirë reklamimin e pozitës, memorandumimin e dizajnit të marrëveshjes, monitorimin e progresit, dokumentimin e përvojës, reflektimin, vlerësimin dhe, në fund, kultivimin e marrëdhënieve profesionale afatgjate.”*

Kurset për studentë, staf universitar, dhe biznese do të jenë të disponueshme online, duke u mundësuar pjesëmarrësve t'i përfundojnë sipas kohës që ata/ato vetë e përcaktojnë. Këto kurse do të krijohen dhe finalizohen përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë profesorë dhe përfaqësues të bizneseve, të cilët kanë përvojë të drejtpërdrejt me trajtimin e praktikave të punës. Aktiviteti Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë është i përkushtuar në dizajnimin e resurseve dhe ofrimin e mbështetjes në bashkëpunim të ngushtë me partnerët. Synimi është të ofrohet asistencë për universitetet dhe bizneset në avansimin e praktikave të tyre ekzistuese dhe forcimin e kanaleve të tyre të bashkëpunimit, për të maksimizimin e përfitimeve për studentët.

#InternshipManagement #ExperientialLearning #OnlineLearning #ISU #USAID #UIOWA #UPgrading #UHZ #UPZ